


Observeri i Kosovës:

Lufta Diplomatike Ruse dhe
Dezinformimi Medial

1 nëntor 2021 –
15 janar 2022



INFORMATA BAZIKE:

Observeri i Kosovës: Lufta Diplomatike Ruse dhe Dezinformimi Medial – është një raport tremujor që i analizon deklaratat publike dhe publikimet e establishmentit rus të politikës së jashtme dhe tiparet e lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e shënjestrojnë Kosovën, të botuara në mediat ruse në gjuhët angleze dhe serbe.

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbretëri e Bashkuar

MOHIM:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë botim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1, 10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

Web-site: www.kipred.org

Email: info@kipred.org

PËRGATITUR NGA:

Lulzim Peci

Përmbledhje Ekzekutive

Observeri i Kosovës: Lufta Diplomatike Ruse dhe Dezniformimi Medial është një raport tremujor që synon t'i analizojë deklaratimet publike, konferencat për shtuyp, artikujt, dhe dokumentet e tjera, të botuara në uebsajtet e Kremlinit, të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Federatës Ruse, të Misionit të Përhershëm Rus në Kombet e Bashkuara, të Misionit të Përhershëm Rus në OSBE, të Përfaqësimit të Përhershëm Rus në Këshillin e Evropës, të Misionit të Përhershëm Rus në BE, dhe të Ambasadës Ruse në Serbi, e të cilat janë eksponentët kyç të luftës diplomatike ruse kundër Kosovës. Pos kësaj, ky Observer i analizon edhe karakteristikat e lajmeve që përmbajnë dezinformata për Kosovën të botuara nga mediat e përzgjedhura paraprakisht, dhe atë nga Russia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran dhe Pravda Report, të cilat janë dorë e zgjatur e establishmentit të Politikës së Jashtme Ruse në luftën e saj diplomatike kundër Kosovës.

Lidhur me këtë, analizat e deklaratave, të brifingjeve, të artikujve, dhe të dokumenteve të tjera të establishmentit të politikës së jashtme ruse, të botuara nga 1 nëntori 2021 deri më 15 janar 2022, tregojnë se gjatë kësaj periudhe që përkon me përgatitjet për pushtimin e Ukrainës, establishmenti i politikës së jashtme i Moskës e ka ngritur nivelin e keqpërdorimit të Kosovës në luftën e vet diplomatike kundër Perëndimit. Pos me Krimenë, Moska tash është duke e krahasuar sjelljen e Qeverisë së Kosovës me atë të Ukrainës, ndërkaq, atë të pjesës veriore të Kosovës me rajonet separatiste të Donetskut dhe të Luganskut, në të njëjtën kohë kur është duke i paraqitur si viktima rusët etnikë në Ukrainë dhe serbët etnikë në Kosovë. Në këtë kontekst, ajo ka vazhduar t'i manipulojë narrativat e intervenimit të NATO-s në ish-Jugosllavi, duke u përpjekur që të rrënoj themelet shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës, si dhe kredibilitetin e angazhimit të BE-së në dialogun Prishtinë – Beograd, paralelisht me rolin e Brukselit në implementimin e Marrëveshjes së Minskut, ta akuzojë Kosovën dhe Perëndimin që synimi i tyre është që “fuqia ballkanike e barotit” të shpërthejë, duke e shënjestruar më në veçanti Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë dhe kreun e Misionit të OSBE-së, Ambasadorin Britanik Davenport, dhe duke e paraqitur komunitetin serb dhe Kishën Ortodokse në Kosovë si të kërcënuara dhe të shtypura. Ajo që është më interesantja, është pothuaj e evidente që në takimin midis Presidentit Putin dhe atij Vučić, të 25 nëntorit 2021, është diskutuar edhe rritja e dislokimit të ardhshëm ushtarak rus në kufirin me Ukrainën, dhe koordinimi i mundshëm ruso-serb në synimet e tyre në Ballkanin Perëndimor, në dritën e pushtimit vijues të Ukrainës nga ana e Putinit.

Lajmet që kanë pasur dezinformata dhe keqinformime të karakterit malinj për Kosovën, të botuara gjatë kësaj periudhe nga mediat ruse të përmendura më sipër, ishin të përqendruara kryesisht në rrënimin e themeleve të angazhimit perëndimor në shtet-ndërtimin e Kosovës dhe në dialogun Prishtinë–Beograd, të vijuar nga ato përqendrimi i të cilave ishte rrënimi i themeleve të legalitetit të shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës, paraqitja e komunitetit serb dhe e Kishës Ortodokse në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara, dhe ndryshimi i narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi.

Lufta Diplomatike Ruse ndaj Kosovës

Gjatë kësaj periudhe, Kremli, Ministria e Jashtme Ruse, Misioni i Përhershëm Rus në OSBE, dhe Ambasada Ruse në Serbi, e kanë shënjestruar Kosovën drejtpërdrejtë, ose në një kontekst më të gjerë, në një numër deklaratash, konferencash për shtyp, dhe deklaratash për shtyp, ndërkohë që Misioni i Përhershëm i Ruisë në Kombet e Bashkuara, Misioni i Përhershëm Rus në BE, dhe Përfaqësimi i Përhershëm Rus në Këshillin e Evropës, nuk kanë postuar në ueb-faqet e tyre ndonjë publikim lidhur me Kosovën. Në këtë kuadër, teksti vijues do ta paraqesë dhe do ta shqyrtojë temën bazuar në analizën kronologjike të këtyre veprimtarive shënjestruese të luftës diplomatike ruse kundër Kosovës.

Lidhur me këtë, më 3 nëntor 2021, zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Ruse, Maria Zakharova¹ i akuzoi shqiptarët e Kosovës për përkeqësimin e gjendjes në rajon dhe për sjelljen e saj buzë përshkallëzimit, me përkrahjen e Perëndimit, duke i shënjestruar më në veçanti diplomatët e Mbretërisë së Bashkuar. Ajo pohoi se “situata në Ballkan është duke u bërë më e keqe, dhe se fitili i fuqisë ballkanike të barotit mund të ndizet në çdo çast për shkak të aksioneve të ekstremistëve të Kosovës, me bashkëfajësinë ose inkurajimin e drejtpërdrejtë të patronëve të tyre Perëndimorë.” Sipas saj, burimi i problemit janë “ultranacionalistët shqiptarë që e kanë marrë pushtetin atje dhe që janë posaçërisht aktivë duke i treguar muskujt e tyre para zgjedhjeve lokale,”² si dhe përkrahësit e tyre Perëndimorë që “në vitin 1999 e nisën sulmin e NATO-s kundër Jugosllavisë me qëllim që Kosovën ta heqnin nga Serbia, pa i marrë parasysh viktimat e shumta njerëzore,” dhe që po ashtu janë duke u përpjekur që Serbinë ta shtyjnë “që të heqë dorë nga interesat kombëtare dhe kujtesa historike.” Në këtë kontekst, në një sulm të pashembullt, ajo e akuzoi Britaninë e Madhe për inkurajimin e drejtpërdrejtë të “provokuesve kosovarë,” duke deklaruar që “arbitrariteti anti-serb është bekuar nga Ambasadori Britanik në Prishtinë, dhe nga bashkatdhetari i tij në krye të Misionit të OSBE-së në Kosovë.”³

Në konferencën për shtyp të 13 nëntorit 2021, pas vizitës në Paris, Ministri i Jashtëm Rus, Sergey Lavrov, e akuzoi Bashkimin Evropian për paaftësinë e tij për të ushtruar trysni në Kosovën për ta implementuar marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, duke u përpjekur që t’ia rrëronte themelet kredibilitetit të tij. Ai pohoi që “Bashkimi Evropian, duke vepruar si ndërmjetës i Asamblesë së Përgjithshme të KB, është i paaftë për t’i zbatuar vendimet e dakorduara në mes

¹ Sputnik Serbia, Zaharova: Balkansko bure baruta u svakom trenutku može da plane [Fuqia ballkanike e barotit mund të shpërthejë në çdo çast], 3 nëntor 2021, [Zaharova: Balkansko bure baruta u svakom trenutku može da plane - 03.11.2021, Sputnik Srbija \(sputniknews.com\)](https://www.sputniknews.com/en/serbia/2021/11/03/zaharova-balkansko-bure-baruta-u-svakom-trenutku-moze-da-plane-03.11.2021/)

² Raundi i parë dhe i dytë i zgjedhjeve lokale në Kosovë janë mbajtur më 17, përkatësisht, me 14 nëntor, 2021.

³ Ibid.

Beogradit dhe Prishtinës në vitin 2013,” duke e synuar kështu para së gjithash marrëveshjen për themelimin e Asociacionit të Komunave (me Shumicë) Serbe në Kosovë, i cili, sipas tij, do “t’iu mundësonte serbëve që ta ruajnë identitetin e tyre në këtë territor.”⁴

Nga ana tjetër, me rastin e takimit me Presidentin serb Aleksandar Vučić, më 25 nëntor 2021, Presidenti Putin ia kushtoi një vëmendje të veçantë bashkëpunimit ushtarak midis Moskës e Beogradit, ndërkohë që duke folur për bashkëpunimin në skenën ndërkombëtare, ai vetëm e theksoi “zgjidhjen e Kosovës,” duke e theksuar përkrahjen për pozitën e Serbisë.⁵

Në këtë mënyrë, më 9 dhjetor 2021, Përfaqësuesi i Përhershëm i Rusisë në OSBE, z. Alexander Lukashevich, deklarantën e tij për situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor⁶ e filloi me emërtimin e Kosovës si “Krahina Autonome e Kosovës e Metohisë,” pavarësisht faktit që OSBE-ja shprehjen Kosovë e shfrytëzon për ta adresuar atë si një vend. Ai i akuzoi “shqiptarët e Kosovës” për atë që po përpiqeshin t’i merrnin “zonat e populluara me serbë” në pjesën veriore të Kosovës, dhe të ushtronin dhunë kundër civilëve serbë, kur kjo në një mënyrë evidente nuk ishte e vërtetë.

Lidhur me këtë, duhet të vërehet që Policia e Kosovës nuk e ka shfrytëzuar forcën gjatë operacionit të saj të “mbrojtjes parandaluese,” të kalimit kufitar të Jarinjës dhe të Brnjakut me Serbinë, dhe që ky problem u zgjidh me marrëveshjen për tabelat e regjistrimit të automjeteve, të ndihmuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, të arritur në Bruksel më 30 shtator 2021, ndërkohë që më 13 tetor 2021 Policia e Kosovës e kreu një operacion në të tërë vendin kundër kontrabandimit dhe krimit të organizuar, përfshirë edhe veriun e vendit.

Për më tepër, ai e akuzoi pa kurrfarë dëshmish inteligjencën e Mbretërisë së Bashkuar për organizimin e “trazirave” më 13 tetor 2021 duke e vënë kështu Londrën përsëri në ballë të kritikave kundër Perëndimit në Kosovë. Pos kësaj, ai e akuzoi Kosovën për incidentet që i përfshinin vendndodhjet e trashëgimisë fetare ortodokse serbe, më në veçanti për rastin e Kishës Ortodokse në qytetin e Zveqanit, që ishte vjedhur më 30 nëntor, 2021, duke e shpërfillur me këtë rast faktin që kjo komunë ndodhet në veri të vendit, që është e populluar 100% nga popullata serbe, dhe që Stacioni i Policisë së

⁴ Vërejtjet dhe përgjigjet e Ministrit të Jashtëm Serbey Lavrov në pyetjet e mediave pas vizitës së tij në Francë, Paris, më 12 nëntor 2021, https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1785967/

⁵ Bisedat me Presidentin e Serbisë Aleksandar Vučić, Kremli, <http://en.kremlin.ru/events/president/news/67194>

⁶ Deklaratë e Alexander Lukashevich, Përfaqësuesi i Përhershëm i Federatës Ruse në takimin e 1348 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së për situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor. [Alexander Lukashevich on the security situation in the Western Balkans, 9 December 2021 - Speeches and Interviews of the Permanent Representative - Permanent Mission of the Russian Federation to the OSCE \(mid.ru\)](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1785967/)

Kosovës në këtë komunë përbëhet kryesisht nga oficerët serbë të Policisë së Kosovës, që janë të ngarkuar me sigurinë e popullatës lokale.

Nga ana tjetër, Ambasadori rus në Serbi, Aleksandar Bocan-Harchenko, në prezantimin e tij në temën “Partneriteti Strategjik Ruso-Serb dhe gjendja në Ballkan,” të organizuar nga Instituti i Beogradit për Politikën dhe Ekonominë Ndërkombëtare më 14 dhjetor 2021, kushtin që i është vënë Serbisë për ta njohur Kosovën e konsideron si marrëzi, dhe tha që lidhja e zbatimit të marrëveshjeve me njohjen e Kosovës nga Serbia është e pamundur dhe dëmtoese. Për më tepër, ai ngulmonte që BE-ja duhet të ushtrojë tryzni në Kosovën për t’i zbatuar të gjitha marrëveshjet e nënshkruara, ndërkohë që pohonte se në të kundërtën, BE-ja do ta humbte kredibilitetin.

Në intervistën dhënë gazetës boshnjake “Oslobodjenje,” më 24 dhjetor 2021,⁷ Ministri i Jashtëm Rus Lavrov mohoi ekzistencën e ndikimit malinj rus në rajon, dhe për këtë narrativ ai i akuzoi “rusofobët lokalë,” duke shtuar që kjo “me gjasë i shërben interesave të disa aktorëve ekstra-rajonale” [Perëndimit], që preferojnë “të peshkojnë në ujë të turbullt.” Për më tepër, ai e akuzoi Perëndimin për tërheqjen zvarrë brenda NATO-s të disa vendeve të caktuara të rajonit duke e shpërfillur vullnetin e popullit të tyre (Mali i Zi), dhe e fajësoi NATO-n për intervenimet e veta në vitet 1990. Lidhur me Kosovën ai e pohoi qëndrimin tashmë të përsëritur të Moskës që Beogradi dhe Prishtina duhet ta arrijnë “një zgjidhje reciprokisht të pranueshme të bazuar në Rezolutën 1244 të KS KB,” dhe që kjo zgjidhje duhet të miratohet nga Këshilli i Sigurisë së KB.

Në konferencën për shtyp të 13 janarit 2022, zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Ruse, Maria Zakharova, në një reagim ndaj shpalljes nga ana e Ministrisë së Jashtme të Kosovës si persona non-grata të zyrtarit rus të UNMIK-ut, Andrey Nikolaevich Antonov, më 31 dhjetor 2021, ndër të tjera pohoi që ky veprim është “një vazhdim i politikave provokuese të autoriteteve të Kosovës që synojnë spastrimin e atyre anëtarëve të Misionit të KB që e kanë një këndvështrim objektiv për situatën në terren.”⁸ Mirëpo, ashtu siç kanë raportuar mediat në Kosovë, sipas zyrtarit të UNMIK-ut të identifikuar me inicialet e veta si P.T., Antonovi ishte duke ushtruar tryzni në strukturat politike serbe

⁷ Intervista e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov për gazetën Oslobodjenje me rastin e 25 vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Federatës Ruse dhe Bosnjes e Hercegovinës më 26 dhjetor 1996, botuar më 24 dhjetor 2021, https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1791944/

⁸ Konferencë për shtyp e Zëdhënësës së Ministrisë së Jashtme, Maria Zakharova, Moskë, 13 janar 2022. https://www.mid.ru/fr/press_service/spokesman/briefings/1794251/?lang=en

në komunat me shumicë serbe, dhe ishte i përfshirë në bllokimet në pjesën veriore të Kosovës në shtator 2021.⁹

Mirëpo, ndryshimi i madh i narrativave ruse ndaj Kosovës është bërë nga Ministri i Jashtëm Lavrov në intervistën që i është dhënë emisionit të bisedës politike ‘The Great Game’ [Loja e Madhe] të programit Channel One, më 13 janar 2022.¹⁰ Në deklaratën e tij ai i futi në të njëjtin ambalazhim marrëveshjet e Minskut dhe marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe (AKS) në Kosovë, si dhe AKS me rajonet separatiste të Donetskut dhe të Luganskut. Ai pohoi që “marrëveshja për AKS e parashihte dhënien e të drejtave autonome për serbët, të cilat ta kujtojnë fuqishëm atë që thuhet në marrëveshjet e Minskut për republikat popullore të Donetskut dhe të Luganskut,” dhe i paraqiti që të dyja këto përmes thjerrëzave të pan-sllavizmit, duke theksuar që “këto marrëveshje kanë të bëjnë me të drejtat e sllavëve, dhe posaçërisht të sllavëve të krishterë ortodoksë.” Është e evidente që me këto deklarata Ministri Lavrov synon t’i paraqesë si viktimat komunitetin serb në Kosovë ngjashëm me rusët në rajonet separatiste të Donetskut dhe të Luganskut që janë përdorur si justifikim për intervenimin ushtarak në Ukrainë.

Pos kësaj, në vërejtjet dhe përgjigjet e tij në pyetjet e mediave në konferencat e shtypit për performansën e politikës së jashtme ruse në vitin 2021, në Moskë, 14 janar 2022, Ministri i Jashtëm Lavrov qartësoi më tutje krahasimin e tij të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe me rajonet separatiste të Donetskut e të Luganskut, duke fajësuar BE-në për mungesën e zbatimit të të dyja marrëveshjeve.¹¹ Është interesante që sipas tij AKS synon që t’u japë vetëm serbëve në pjesën veriore të Kosovës “të drejtat kryesore të autonomisë për çështjet kulturore, humanitare, të gjuhës dhe ato edukative, si dhe në fushën e lidhjeve të veçanta me Serbinë,” të cilat janë të ngjashme me të drejtat që “janë miratuar për republikat e Donetskut dhe të Luganskut në Paketën e Masave të Minskut.” Me këtë deklaratë, Lavrov synon qartë ridraftimin e marrëveshjes së AKS, dhe projektimin e pjesës veriore të Kosovës ngjashëm me ambiciet e dy rajoneve separatiste të Ukrainës.

⁹ Gazeta Express, Rusi “non grata” i UNMIK-ut, po bënte presion mbi serbët e veriut, 13 dhjetor 2021, <https://www.gazetaexpress.com/rusi-non-grata-i-unmik-ut-po-bente-presion-mbi-serbet-e-veriut/>

¹⁰ Intervista e Ministrit të Jashtëm Sergey Lavrov për emisionin e bisedës politike “The Great Game” të Kanalit Një, Moskë, 13 janar 2022, [Foreign Minister Sergey Lavrov’s interview on Channel One’s “The Great Game” political talk show, Moscow, January 13, 2022 - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \(mid.ru\)](https://www.mid.ru/ru/foreign_policy/news/1794396/?lang=en)


¹¹ Vërejtjet dhe përgjigjet në pyetjet e mediave të Ministrit Sergey Lavrov në konferencën për shtyp për performansën e politikës së jashtme ruse në vitin 2021, Moskë, 14 janar 2022, https://www.mid.ru/ru/foreign_policy/news/1794396/?lang=en

Për më tepër, ai e akuzoi BE-në që ishte e përfshirë në draftimin e të dyja këtyre dokumenteve, domethënë, të tërë Bashkimit Evropian në rastin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, dhe në rastin e Marrëveshjes së Minskut, BE-në e përfaqësuar nga Gjermania dhe Franca në formatin Normand, dhe që këto nuk u zbatuan nga “Prishtina në rastin e Kosovës dhe të regjimit të Kievit në rastin e marrëveshjeve të Minskut.” Është interesante që krahasimi i Kosovës me Krimenë ka pushuar, dhe që Kosova ka filluar të krahasohet me Ukrainë, njëkohësisht me krahasimin e gjendjes në pjesën veriore të Kosovës me atë të rajoneve separatiste të Donetskut dhe të Luganskut.


Dezinformimi Medial Rus për Kosovën

Mediumet e përzgjedhura që origjinën e kanë në Rusi dhe që janë monitoruar nga 1 nëntori 2021 deri më 15 janar 2022, janë Sputnik International, Sputnik Serbia, Russia Today, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, UNZ, The Duran dhe Pravda Report.


Monitorimi i të dhënave tregon se gjatë kësaj periudhe këto medime i kanë publikuar 598 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kishin të bënin me Kosovën. Sputnik – Botimi në Serbisht i botoi 408, TASS-i 13, Russia Today 11, Sputnik International 8, Russia Insider 6, Pravda Report 3, UNZ 3, Meduza 2, Moscow Times 2, Newsfront 2, dhe Durani asnjë.



Shqyrtimi i lajmeve të botuara nga këto media që është bërë nga KIPRED-i tregon se nga 458 lajmet që kishin të bënin drejtpërdrejt ose tërthorazi me Kosovën, 79 (17,2%) prej tyre përmbanin dezinformata.




Numri më i madh i dezinformatave është botuar nga Sputnik Serbia (62), që është vijuar nga Russia Insider (5), Russia Today (3), TASS(2), Pravda Report (2), UNZ (2), Sputnik International (1), Meduza (1), Moscow Times (1), Newsfront (0) dhe The Duran (0).




Me qëllim që ta kemi një pamje më të mirë të modeleve dezinformuese që e shënjestrojnë Kosovën, në lajmet e botuara nga botimet e sipërpërmendura mediale ruse, përqendrimi kryesor i përmbajtjeve të tyre është grumbulluar rreth synimeve vijuese dezinformuese:

- Rrënimi i themeleve të legalitetit të shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës.
- Ndryshimi i narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi.
- Rrënimi i themeleve të kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtetndërtimin e Kosovës dhe në dialogun Prishtinë – Beograd.
- Paraqitja e komunitetit serb dhe e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara.

Lidhur me përmbajtjen e lajmeve që kanë pasur dezinformata, të botuara nga këto botime mediale ruse, numri më i madh i tyre ka synuar t’ia rrënojë themelet kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtet-ndërtimin e Kosovës, dhe në dialogun Prishtinë – Beograd (24), pastaj, t’ia rrënojë themelet shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës (21), pasuar nga paraqitja e komunitetit serb dhe Kishës Ortodokse Serbe si të shtypura dhe të kërcënuara (20), dhe t’i ndryshojë narrativat e luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi (14).



Analiza e modeleve të lajmeve dezinformuese të grumbulluara, të botuara nga botimet e sipërpërmendura mediale ruse, tregon se ato janë të përqendruara kryesisht në rrënimin e themeleve të kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtet-ndërtimin e Kosovës, në rrënimin e themeleve të legalitetit të shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës, pastaj në paraqitjen e komunitetit serb dhe të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara, si dhe në dialogun Prishtinë–Beograd. Është interesante, lajmet dezinformuese që synojnë ndryshimin e narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi kanë marrë shumë më pak vëmendje në këto botime mediale sesa në raportin paraprak.



Përfundim

Një zhvillim i rëndësishëm në luftën diplomatike ruse kundër Perëndimit dhe Kosovës që ka ndodhur gjatë kësaj periudhe është ndryshimi e narrativave në prag të sulmit të Putinit kundër Ukrainës. Në dy deklarata të tij, të dhëna më 13 dhe 14 janar 2022, Ministri i Jashtëm Lavrov i krahasoi rajonet separatiste të Ukrainës të dominuara nga rusët, të Donetskut dhe të Luganskut, me pjesën veriore të Kosovës të dominuar nga serbët, si dhe Marrëveshjen e Minskut me atë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, nga aspekti i të drejtave të popullatave ruse dhe serbe në këto dy territore përkatëse. Për më tepër, për “mungesën e implementimit,” Lavrovi e fajësoi “impotencën” e Bashkimit Evropian për ta shtyrë Kievin dhe Prishtinën për t’i respektuar këto dy marrëveshje përkatëse.

Sulmet kundër Perëndimit në Kosovë ishin të përqendruara në veçanti në Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, në Kryesuesin e Misionit të OSBE-së në Kosovë – Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar Michael Davenport, dhe në inteligjencën britanike, për komplotim kundër komunitetit serb në Kosovë, përmes përkrahjes së intervenimit të Policisë së Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, që ishte pjesë e operacionit kundër krimit të organizuar që ndodhi në tërë Kosovën, më 13 tetor 2021, si dhe për “përkrahjen” e vendimit të Qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës për të mos e lejuar mbajtjen në territorin e Kosovës të referendumit për ndryshimet kushtetuese në Serbi.

Nga ana tjetër, Kremlini i ka dhënë disa deklarata të shkurtëra hyrëse të takimit midis Presidentit Rus Vladimir Putin dhe Presidentit Serb Aleksandar Vučić që u mbajt më 25 nëntor 2021 në Sochi,¹² edhe përkundrejt faktit që vetë takimi zgjati rreth tri orë. Për më tepër, sipas TV Pink serbe, të cituar nga Radio Free Europe, Vučići e lëshoi takimin duke qenë krenar për bashkëpunimin ushtarako-technik me Rusinë, dhe ai lutej për arritjen e shpejtë në Serbi të armatimeve të caktuara taktike, duke cituar në veçanti armët anti-tanke. Dhe, më interesantja, Vučići e theksoi urgjencën e marrjes së këtyre armëve ruse sepse, sipas tij “*do të ketë gjëra të tjera të mëdha të një interesi strategjik për Serbinë në një të ardhme, dhe atë në një të ardhme jo shumë të largët,*” ku ai shtoi “kështu që, gjërat e para do t’i kemi para fundit të vitit në Serbi.”¹³

Duke i pasur parasysh këto deklarata të Vučićit, është pothuaj e evidente që në takim me Presidentin Putin ata e kanë diskutuar grumbullimin vijues ushtarak rus në kufirin me Ukrainën, si dhe

¹² Bisedat me Presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić, The Kremlin, <http://en.kremlin.ru/events/president/news/67194>

¹³ Radio Free Europe, Russian, Serbian Presidents Emerge From Meeting With Talk Of Gas Deal, 'Tactical' Weapons, 25 nëntor 2021, <https://www.rferl.org/a/putin-vucic-gas-weapons/31579354.html>

koordinimin e mundshëm ruso–serb në synimet e tyre në Ballkanin Perëndimor në dritën e sulmit të ardhshëm të Putinit kundër Ukrainës. Duhet të vërehet që një javë pas takimit të Vučićit me Putinin, mediat e Shteteve të Bashkuara raportuan për synimet ushtarake të Kremlinit ndaj fqinjit të vet.¹⁴ Në këtë aspekt, krahasimi i rajoneve separatiste të Donetskut dhe të Luganskut me pjesën veriore të Kosovës nga Ministri Lavrov, mbetet një çështje e shqetësimit lidhur me koordinimin e mundshëm të veprimeve serbe dhe ruse në raport me Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor.

Në këtë sfond, krahasimet absurde të Kosovës dhe të intervenimit të NATO-s me Krimenë dhe me rajonet separatiste të Donetskut dhe të Luganskut të Ukrainës, si dhe ato të kaluarat me Osetinë Jugore dhe Abkhazinë në Gjeorgji, të shfyrëzuara nga regjimi i Putinit, nuk lëjnë vend për dyshim se janë duke u ndjekur për t'i justifikuar agresionet dhe politikat hegjemoniste në “fqinjësinë të afërt” të Rosisë, e të cilat janë të zhveshura nga normat më themelore të respektimit të të drejtave njerëzore dhe të të drejtës ndërkombëtare.

Së fundi, analizat e diskurseve të lajmeve që përmbajnë dezinformime dhe keqinformime malinje (79) të mediave të përzgjedhura, të cilat janë një dorë e zgjatur e Moskës, tregojnë se, në përgjithësi, ato i përcjellin narrativat e establishmentit të politikës së jashtme të Rosisë, dhe se Sputnik Serbia, Sputnik International, Russia Today dhe TASS-i mbeten në ballë të këtyre operacioneve informative malinje kundër Kosovës.

¹⁴ Washington Post, Russia planning massive military offensive against Ukraine involving 175,000 troops, U.S. intelligence warns, 3 dhjetor 2021.